



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 258, datë 12.11.2019

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Lirim me kusht”.
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.
4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.
5. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale në

ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 278/2-25 dhe 303 të Kodit Penal.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj.; të paditur: {...}, etj.; me objekt: “Pavlefshmëri veprimesh juridike, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale me kërkues: {...}; në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79, germa “ë” e 22, 278/1 e 280 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 274 dhe 238 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: {...}; {...}; me objekt: “Detyrimi i palës së paditur të na kompensojë me sipërfaqe takuese sipas koeficientit të tregut për sipërfaqen e zënë me ndërtim mbi truallin në pronësi të paditësve prej 140 m². Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për dëmin efektiv të shkaktuar nga shfrytëzimi i pasurisë”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, etj.; me objekt: “Shpërblim dëmi, sigurim padie, etj”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, {...} (relatore), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; me objekt: “Rishikim vendimi penal të formës së prerë nr.12-2018-1955/174, datë 02.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj.; të paditur: {...}; me objekt: “Shpërblim dëmi jopasuror”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}, {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Shpërblim dëmi jopasuror”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurave: {...}, {...}; të akuzuara për kryerjen e veprave penale: “Mashttrim”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me kërkues: {...}, etj.; në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 130/a/4 dhe 321/2 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me kërkues: {...}; në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; me objekt: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal (numër nuk ka) të bazuar në materialin kallëzues nr.3147, datë 01.11.2018 të Komisariatit Vlorë (të prokurores {...})”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, {...} (relator) si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}; me objekt: “Zgjidhjen e marrëveshjes për sigurimin vullnetar me nr.56686, datë 12.03.2019, ndërmjet I.S.SH Tiranë, përfaqësuar nga D.R.S.SH Gjirokastër dhe personit të siguruar vullnetarisht z. {...}. Kthimin e shumës 67.392 lekë personit të siguruar vullnetarisht z. {...}. Detyrimin e të paditurit D.R.S.SH Gjirokastër të paguaj shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi sikundër janë tarifatat, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për avokatin sipas F.T.SH”.

2. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; person i tretë: {...}; me objekt: “Pavlefshmërinë e njoftimit të likuidimit, shkresës nr.1990 prot., datë 16.08.2019 të të paditurit {...}. Pavlefshmërinë e urdhërit nr.123 prot., datë 16.10.2017 të të paditurit {...}”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}; person i tretë: {...}, {...} me objekt: “Detyrimin e palëve të paditura t’i kthejnë paditësit shumën prej 1.622.515 lekë të derdhura për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si pagim i padetyruar i taksës gjyqësore 1% të vlerës së padisë, të llogaritur gabim nga administrata e palës paditëse. Shpenzimet gjyqësore dhe avokatore në ngarkim të palës së paditur.”

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} (relator), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Ankim i vendimit të mosfillimit të procedimit, datë 15.06.2019”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...} (relatore), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Rishikim vendimi penal nr.113, datë 12.07.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Lirim me kusht”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Ushtrim pa liçencë i veprimtarisë financiare”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për tu mbrojtur, mbetur në tentativë”.

6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; të pandehur: {...}; me objekt: “Dërgim për gjykim i çështjes penale”.
7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.
8. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...} me objekt: “Përfitim nga amnestia”.
9. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Dhunë në familje”.
10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje”, “Ushtrim prostitucioni”.
11. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}, {...}; me objekt: “Konstatim i pavlefshmërisë së kontratës së faktorimit”.
12. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Përmbushje detyrimi”.
13. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Rishikim i vendimit gjyqësor civil nr.1154, datë 08.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë lënë në fuqi me vendimin nr.372, datë 24.11.2015 të Gjykatës së Apelit Korçë”.
14. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Saktësim i kufijve të pronës”.
15. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}; me objekt: “Pjestim sendi në bashkëpronësi (Ankim ndaj vendimit të fazës së parë të pjestimit)”.
16. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Vërtetimin e faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune, për periudhën 1968-1974, në ish Kooperativën Bujqësore Fitore”.
17. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}, {...}; me objekt: “Konstatim pavlefshmërie absolute veprime juridik”.

18. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}; me objekt: “Kërkesë për përjashtim trupi gjykues”.

19. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Dëmshpërblim page”.

20. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, {...}; me objekt: “Pjestim pasurie e përbashkët” (Faza e parë e pjesëtimit).

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: {...}, {...}, {...}; me objekt: “Pavlefshmëri leje ndërtimi”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...} dhe {...}; të paditur: {...}; me objekt: “Shpërblim dëmi”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkues: {...}; në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Falsifikim i dokumentave”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkues: {...}; në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/a/b/dh dhe 278/2 të Kodit Penal.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...} (relatore), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; me objekt: “Prishje e vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues nr.905 të vitit 2019”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...} (relatori), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Shpërdorim detyre”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj.; të paditur: {...}, etj.; me objekt: “Pushim cënim në pronësi, etj”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...} (relator), {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: Këshilli i Ministrave; të paditur: {...}, {...}, etj; me objekt: “Kërkesë për përjashtim të trupi gjykues”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

2. Të pranohet pjesërisht kërkesa nr.2188 prot., datë 14.10.2019 e Gjykatës së Apelit Shkodër (në lidhje me çështjen e poshtëshënuar), duke u caktuar për këtë çështje vetëm 1 (një) gjyqtar në kushtet e mosevidentimit të “nevojës” për 2 (dy) gjyqtarë në kuptim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar. Përfundimisht gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkesë: {...}; me objekt: “Pushim gjykimi”.

GJYKATA E APELIT PËR KRIME TË RËNDA

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, {...} dhe {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/2 dhe 333/a/2 të Kodit Penal.

GJYKATA E LARTË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Miratimin e ekstradimit të shtetasit {...}, nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Serbisë. Mbajtjen në paraburgim me masë “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale deri në ekstradim e tij për në Republikën e Serbisë”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër; me objekt: “Miratimin e ekstradimit të shtetasit kosovar {...}, i biri i {...} dhe i {...}, i datëlindjes 14.02.1964, nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë. Mbajtjen në paraburgim me masë sigurimi “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale deri në ekstradimin e shtetasit {...}, për në shtetin Italian”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Shqyrtimi i kërkesës së ardhur nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.230/26 prot., datë 08.10.2018, që i ka dhënë rrugë vijimit të procedurave të ekstradimit nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar {...}.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR